

## TAKIMI I KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL ME KËSHILLIN E PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS



Në kuadrin e bashkëpunimit ndërinstitucional me institucione brenda dhe jashtë vendit, më datë 29.09.2022, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, znj. Pranvera Strakosha, priti në një vizitë pune Kryetarin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, z. Jeton Koca, së bashku me anëtarët e Këshillit znj. Ardita Haxhnikaj-Demi dhe z. Arben Mehmeti.



Në fokus të këtij takimi ishte diskutimi i një projekt marrëveshje bashkëpunimi, qëllimi i së cilës është shkëmbimi i ekspertizave, eksperiencave dhe praktikave të mira me synimin për të ofruar një mbikëqyrje më profesionale e cila do të garantojë respektimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil; organizimi i takimeve të përbashkëta të punës në përputhje me nevojat dhe në kontekstin e procedurave specifike të trajtimit të ankesave; shkëmbimi i akteve që dalin gjatë veprimtarisë institucionale të dy palëve (*vendime apo akte të tjera përfundimtare*) të cilat i konsiderojnë me interes për ndërtimin e praktikave në fusha të caktuara dhe që mund të kenë ndikim dhe t'i

vijnë në ndihmë zgjidhjes së rasteve të njëjta për palët; asistenca në hartimin e raporteve të aktiviteteve të përbashkëta të zhvilluara sipas dhe për zbatim të kësaj Marrëveshjeje; komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit mbi përditësimin e kuadrit ligjor në të dy vendet; bashkëpunimi për shkëmbimin e njohurive, informacionit dhe praktikave në kontekstin e harmonizimit të legjislacionit.